



U zhvillua në Tiranë Komiteti i Monitorimit i Programit IPARD II, mekanizmi që monitoron efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të Programit IPARD. Ky komitet i përbërë nga shoqata përfaqësuese fermere, organizata të zhvillimit rural, anëtarë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucione të tjera publike, mbledhi strukturat e akredituara nën drejtimin e DG-Agri dhe Komisionit Evropian, për të analizuar performancën e IPARD II, zbatueshmërinë e këtij programi, shprehur me vlerësime edhe në Progres Raportin e BE-së, si dhe hapat që po ndiqen për IPARD III. Jemi krenarë të rendisim Shqipërinë të parën në rajon për përthithjen e fondeve dhe përgatitjen e IPARD III. Këtë vlerësim shprehur fort DG-Agri dhe Komisioni Evropian.

**7470 FERMERË APLIKANTË NË SKEMËN MBËSHETËSE PËR KULTIVIMIN E GRURIT**

7470 fermerë nga e gjithë Shqipëria kanë aplikuar në Skemën Mbështetëse për Kultivimin e Grurit. Me një sipërfaqe të vetëdeklaruar që shkon në rreth 30 mijë hektarë në total, falënderojmë fermerët të cilët i janë përgjigjur politikës sonë të re për t'i dhënë prioritet prodhimit vendas të grurit.

**INSPEKTIM GJATË PUNIMEVE TË KAMPUSIT TË RI PËR KONVIKTET E REJA NË UBT ME KRYEMINISTRIN RAMA**

Ndoqem nga afër punimet me Kryeministrin, Rektor Sallakun, prof Merkoçi në kampusin e ri që po ndërtohet nga Bashkia e Tiranës ku përveç konvikteve të reja, do të jetë qendra e re e inovacionit dhe shkencës për nanoteknologji, ku do të punojnë dhe dy grupe kërkimore shkencore të dedikuara për bujqësinë. Punimet u ndoqën nga shkencëtarë të institutëve të kërkimit më në zë në botë të cilët kanë objektin ku do të vijin të kryejnë kërkim shkencor në nanoteknologji.

**RITEN EKSPORTET BUJQËSORE TË 9 MUJORIT 2022**



Vazhdon rritja e konsoliduar e eksporteve bujqësore në 9-mujorin e vitit 2022. Krahasimi me të njëjtën periudhë të një viti më parë, është regjistruar një rritje prej 58 milionë euro më shumë ose 21.4%. Nga 270 milionë euro në 9 mujin 2021 në 328.4 milionë euro këtë vit. Gjithashtu rritja është regjistruar dhe në sasi, nga 263 mijë tonë në 313 mijë tonë, duke e rritur sasinë e eksportuar me 50 mijë tonë më shumë ose 19.1%.

**SFIDAT DHE MBËSHETETJA E DHËNË NË SEKTORIN E PESHKIMIT**

Në portin e Peshkimit në Durrës me Kryeministrin Rama dhe peshkatarët për të folur për sfidat dhe mbështetjen e dhënë në sektorin e peshkimit përgjatë 2022. Mbështetur peshkatarët me naftë pa taksë. Mbështetur peshkatarët me pagesë direkte 40 lekë për litër. Mbështetur me investime në rinovimin e flotës së anijeve të peshkimit. Investime në infrastrukturë për shtimin e kapaciteteve ankoruese në portin e peshkimit Durrës. Vijnë puna për ndërtimin e rrjetit të markatave të peshkut në të gjitha portet e vendit.



**VIZITË ME KRYEMINISTRIN RAMA NË SERAT E FIDANËVE NË ELBASAN**

Në serat e fidanëve të njeriut shembull të punës. Agimit, i cili së bashku me skuadrën e tij prej më shumë se 30 punëtorësh, prodhon sot perime për vendin e për eksport. Ky investim përdor teknologji të gjelbër të fjalës së fundit me zero ndotje në mjedis, me më pak kosto për fermerin, dhe me eliminim të pesticidëve të tepërta. Kjo pikë ku prodhohen 14 milionë fidanë në vit kontribuon në rritjen e cilësisë përveçse të sasisë, ndërkohë që fermerët mbështeten edhe nga skemat gjithnjë në rritje të qeverisë për fidanët e regjistruar.

**PREZANTOHET SKEMA E PARË KOMBËTARE E TRAJNIMIT NË BUJQËSI**



Bashkë me Universitetin Bujqësor të Tiranës prezantuam skemën e parë kombëtare të trajnimit në bujqësi në të cilën mbi 2000 fermer dhe mbi 600 ekstensionistë dhe specialistë të bujqësisë do të përditësojnë njohuritë e tyre në fushën e menaxhimit të integruar të shëndetit të bimëve, praktikave më të mira në kultivimin e perimeve, drufrutorëve, bimëve të arave, sistemeve dhe teknologjive të avancuara të mbarëshimit të kafshëve, menaxhimin e sipërmarrjeve bujqësore si dhe përgatitjen e analizave dhe planeve të biznesit.

**36 GRA ARTIZANE MARRIN TITULLIN "MJESHTRË" DHE "NDIHMËS MJESHTRË" NË CEREMONINË E ORGANIZUAR NGA DHOMA KOMBËTARE E ZEJTARISË PËR PËRPUNIMIN E LESHIT DHE GURIT**

36 gra artizan marrin titullin "Mjeshtër" dhe "Ndihmës Mjeshtër" në përpunimin e leshit dhe gurit, apo në prodhimin e sapunit dhe të detergjentëve alternativë, të njohur nga Dhoma e Zejtarisë në Koblenz, Gjermani, do të njihen si të certifikuar nga vendet e Bashkimit Evropian.

Ky certifikim do të sjellë vlerë në rritjen e ekonomive të vogla për Shkodrën, Tropojën, Koplikun, Korçën dhe Kukësin.